



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.94, datë 09.05.2022

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR ANALIZIMIN E AFTËSIVE
PROFESIONALE TË PROKURORES MARIOLA MËRTIRI”**

Bazuar në nenin 179/b dhe në nenin “E”, të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 40 dhe 42 pika 1, të ligjit Nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me raportin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokurores **Mariola Mërtiri**, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij Raporti i dërgohet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më datë 09.05.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
ALFRED BALLA

ZV/KRYETAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
SOKOL STOJANI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ZEQIR HODA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR
MIRELA BOGDANI